

VENDIM
Nr.523, datë 30.6.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS MARTANESH, TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 804 (tetëqind e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Martanesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Martanesh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3,6,8,9,11,12,16,301-303,305-309,311-313,318,320-327,376,377,379,380,382-385,387 392,394-404,406,408,410-415,448-450,513,514, 522,523,535-540,550-552,636,637,639,644- 647,653,655,660,663,664,667,670,671.	Pyje dhe kullota	Në pronësi
673-674	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
675-681	Varreza publike	Në pronësi
682-689	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
690-695	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
696-698,702,703,707- 710,712,713,715,716,719,720	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
699,700,701,704,705,706,711,714,717,718,721,722	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në përdorim
728-738	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
739	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

	funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	
--	--	--